LIGJ
Nr. 43/2018

PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË SPANJËS, PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMUNITETIT EVROPIAN, PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE ME QËNDRIM TË PAAUTORIZUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet protokolli ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, për zbatimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 9.7.2018

Shpallur me dekretin nr. 10846, datë 26.7.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

PROTOKOLL
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË SPANJËS, PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMUNITETIT EVROPIAN, MBI RIPRANIMIN E PERSONAVE ME QËNDRIM TË PAAUTORIZUAR (PROTOKOLLI I ZBATIMIT)

Palët e Protokollit të Zbatimit,
Republika e Shqipërisë dhe Mbretëria e Spanjës, më poshtë të referuara si "Palët Kontraktuese",
në përputhje me nenin 19 të Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian mbi Ripranimin e Personave me Qëndrim të Paautorizuar (më poshtë e referuar si "Marrëveshja"), të nënshkruar në Bruksel, më 14 prill 2005,
kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Autoritetet kompetente

1. Në përputhje me dispozitat e nenit 1 dhe të nenit 19 të Marrëveshjes, Palët Kontraktuese kanë

përcaktuar autoritetet kompetente të mëposhtme për zbatimin e saj.

- Pranimi, dorëzimi dhe trajtimi i kërkesave të ripranimit, tranzitit dhe shpenzimeve të tyre:

Për Republikën e Shqipërisë:

Ministria e Brendshme
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
Drejtoria e Migracionit
Tel./faks: 00355 4 22 26 932
E-mail: readmission@asp.gov.al

Për Mbretërinë e Spanjës:

Ministria e Brendshme
Drejtoria Kombëtare e Përgjithshme e Policisë
Komisariati i Përgjithshëm për të Huajt dhe Kufijtë
General Pardiñas, 90 dpdo. 28006 Madrid
Kërkesat për ripranim (orari zyrtar): nga e hëna deri të premten: 8:00–21:00.
Tel : +34 913226926 / +34 913226928
E-mail: cgef.ucfstc@policia.es

Kërkesa për tranzit (orari zyrtar): nga e hëna deri të premten: 8:00–21:00.
Tel: +34 913226929
E-mail: cged.0013@policia.es

Pas orarit zyrtar (kërkesa për ripranim dhe tranzit)
Tel : +34 913226839/40/41
E-mail: cged.0039@policia.es
Faks: +34 913226842/44

2. Për qëllimet e nenit 8(3) të Marrëveshjes, misionet kompetente diplomatike ose zyrat konsullore për kryerjen e intervistave të personave që do të ripranohen dhe për lëshimin e dokumenteve të udhëtimit do të jenë:

Për Republikën e Shqipërisë:

Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Madrid
Calle Lagasca, 68, 1B,
28001 MADRID
Kingdom of Spain
Tel.: +34 91 562 6985
Fax: +34 91 561 3775

Për Mbretërinë e Spanjës:

Konsullata e Spanjës në Tiranë
Rruga "Skënderbej", nr. 43
1000, Tiranë
Republika e Shqipërisë
Tel.: +355 4 22 74 960, +355 4 2274 961
Faks: +355 4 22 25 383.

3. Palët kontraktuese informojnë njëra-tjetrën, pa vonesë, nëpërmjet kanaleve diplomatike dhe/ose në mënyrë të drejtpërdrejtë, për çdo ndryshim në listën e autoriteteve kompetente.

4. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese përcjellin me shkrim aplikimet, përgjigjet dhe njoftimet e parashikuara në Marrëveshje dhe në këtë Protokoll Zbatimi, duke përdorur mjetet teknike të komunikimit, kryesisht nëpërmjet *e-mail*-it.

Neni 2

Pikat e kalimit kufitar

1. Transferimi dhe tranzitimi i personave subjekt të këtij Protokolli Zbatimi do të ndodhë në pikat e mëposhtme të kalimit kufitar:

a) Për Republikën e Shqipërisë:
Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin, Tiranë
Komisariati për Kufirin dhe Migracionin, Rinas
Aeroporti Ndërkombëtar "Nënë Tereza"
E-mail: PKK.AeroportiRinas@ASP.gov.al;
DRKM.Tiranë@ASP.gov.al
Tel./faks: 00355 4 23 64 028

b) Për Mbretërinë e Spanjës:
Adolfo Suárez - Madrid - Aeroporti Barajas International;
Barcelona - Aeroporti El Prat International; dhe
të gjitha aeroportet e tjera ndërkombëtare në territorin spanjoll.

Neni 3

Gjuha e komunikimeve

Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese do të përdorin gjuhën angleze për procedurat e kryera të parashikuara në Marrëveshje dhe Protokollin e Zbatimit.

Neni 4

Kërkesa për ripranim dhe kthimi i përgjigjes

1. Në përputhje me nenin 7(3) të Marrëveshjes, Autoriteti Kompetent i Palës kërkuese do të përdorë formularin e përbashkët të kërkesës për ripranim, bashkëlidhur si shtojca 5 e Marrëveshjes. Autoriteti kompetent i Palës së kërkuar duhet t'i kthejë përgjigje kërkesës për ripranim të autoritetit kompetent të Palës kërkuese, në përputhje me nenin 1(4) të këtij Protokolli Zbatimi.

2. Përgjigjja ndaj kërkesës për ripranim do të ketë shënimin që çdo fëmije duhet t'i lëshohet një dokument i veçantë udhëtimi, në rastin e ripranimit të fëmijëve së bashku me prindërit e tyre në territorin e Palës së Kërkuar.

3. Afatet kohore për kthimin e përgjigjes për kërkesën e ripranimit janë të përcaktuara në nenin 10(2) dhe (3) të Marrëveshjes.

4. Nëse janë plotësuar kushtet për ripranim, autoriteti kompetent i Palës së kërkuar duhet të njoftojë me shkrim për këtë autoritetin kompetent të Palës kërkuese, të përcaktuar në nenin 1 të këtij Protokolli Zbatimi, në përputhje me nenin 1(4) të këtij Protokolli Zbatimi.

5. Në rast të një përgjigjeje negative, autoriteti kompetent i Palës së kërkuar duhet të japë arsyet për refuzimin e ripranimit. Në këtë rast, mund të paraqitet një aplikim i ri ripranimi për të njëjtin person, në rast se zbatohet një nga rrethanat e mëposhtme:

a) Paraqiten elemente të reja prove apo të dhëna *prima facie*;
b) Kërkohet një intervistë, në rast se nuk është kërkuar në aplikimin e parë.

Neni 5
Mjetet dhe dokumentet shtesë

1. Nëse autoriteti kompetent i Palës kërkuese konsideron se dokumente të tjera që nuk janë të renditura në shtojcat 1 dhe 4 të Marrëveshjes mund të jenë të rëndësishme për të përcaktuar shtetësinë e personit që pritet të ripranohet apo për të përcaktuar arsyet për ripranimin e shtetasve nga vende të treta apo pa shtetësi, dokumente të tilla mund t'i bashkëlidhen, gjithashtu, aplikimit të ripranimit që i dorëzohet autoritetit kompetent të Palës së kërkuar.

2. Vendimi nëse mund të merren në konsideratë dokumentet e përmendura në paragrafin 1, kur konsiderohet një kërkesë për ripranim, merret nga autoriteti kompetent i Palës së kërkuar.

3. Gjurmët e gishtave të paraqitura së bashku me kërkesën për ripranim duhet të përdoren, kur është e mundur, për të përcaktuar identitetin e personave që do të ripranohen dhe, rrjedhimisht, shtetësinë e tyre ose pajtueshmërinë me kushtet për ripranimin e shtetasve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi.

Neni 6
Intervistat

1. Në përputhje me nenin 8(3) të Marrëveshjes, me kërkesë të Palës kërkuese, nëse nuk mund të paraqitet asnjë nga dokumentet e renditura në shtojcën 1 apo 2 të Marrëveshjes, misioni kompetent diplomatik apo zyra konsullore e Palës së kërkuar duhet të intervistojë personin që do të ripranohet, në mënyrë që të përcaktohet kombësia e tij/e saj, brenda një periudhe maksimale prej tri ditësh pune nga data e kërkesës.

2. Kërkesat për intervistë duhet të shënohen në seksionin F të aplikimit për ripranim (shtojca 5 e Marrëveshjes).

3. Në rastet kur duhet të organizohet një intervistë, një kopje e aplikimit për ripranim duhet t'i dorëzohet nga Pala kërkuese misionit kompetent diplomatik ose zyrës konsullore të Palës së kërkuar, në territorin e Palës kërkuese.

4. Misioni diplomatik apo zyra konsullore e Palës së kërkuar informon autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese të përcaktuara në nenin 1(1) të këtij Protokolli Zbatimi, për rezultatin e intervistës.

5. Afatet kohore të parashikuara në nenin 10(2) dhe (3) të Marrëveshjes fillojnë nga momenti kur merret kërkesa për ripranim, pavarësisht nga momenti kur rezultati i intervistës bëhet i ditur.

Neni 7
Dokumentet e udhëtimit

1. Kur jepet pëlqimi për ripranim, autoriteti kompetent i Palës së kërkuar duhet t'i dorëzojë, gjithashtu, misionit kompetent diplomatik ose zyrës konsullore të Palës së kërkuar, përgjigjen pozitive të aplikimit për ripranim.

2. Pala kërkuese do t'i kërkojë lëshimin e dokumentit të udhëtimit misionit kompetent diplomatik apo zyrës konsullore të palës së kërkuar, nëse përgjigjja nuk është dhënë brenda limitit të kohës së përcaktuar.

3. Misioni diplomatik kompetent apo zyra konsullore e Palës së kërkuar lëshojnë dokumentin e udhëtimit, në përputhje me nenet 2(2), 3(3), 4(2) dhe 5(4) të Marrëveshjes, brenda 3 ditësh pune. Personi i cili do të ripranohet nuk ka nevojë të paraqesë aplikim.

Neni 8
Njoftimi për transferim

1. Bazuar në përgjigjen pozitive të kërkesës së ripranimit nga autoritetet kompetente të Palës së kërkuar, pas së cilës është lëshuar dokumenti përkatës i udhëtimit, në bazë të neneve 2(2), 3(3), 4(2) dhe 5(4) të

Marrëveshjes, autoritetet kompetente të Palës kërkuese duhet të njoftojnë, në përputhje me nenin 1(1) të këtij Protokolli Zbatimi, autoritetin kompetent të Palës së kërkuar, për datën dhe të dhënat e fluturimit për transferimin, si dhe mbi përdorimin e eskortës, në rast se do të përdoret eskorta.

2. Njoftimet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni duhet t'i dërgohen autoritetit kompetent të Palës së kërkuar, të paktën tri ditë kalendarike para kryerjes së transferimit.

3. Asnjë njoftim nuk është i nevojshëm për rastet e parashikuara në nenin 6(2) të marrëveshjes, kur nuk përdoret eskortimi.

Neni 9

Aplikimi për tranzit

1. Autoriteti kompetent i Palës kërkuese duhet t'i drejtohet autoritetit kompetent të Palës së kërkuar, duke dorëzuar kërkesën për tranzitin e shtetasve të vendeve të treta apo personave pa shtetësi, nëpërmjet territorit të Palës së kërkuar, në përputhje me nenin 14 të Marrëveshjes, duke përdorur shtojcën 6 të Marrëveshjes.

2. Tranzitet duhet të ndodhin vetëm me rrugë ajrore dhe brenda të njëjtit aeroport.

3. Një kërkesë për tranzit duhet t'i dorëzohet pa vonesë, por të paktën 5 ditë kalendarike para tranzitit të planifikuar, autoritetit kompetent të Palës së kërkuar.

4. Autoriteti kompetent i Palës së kërkuar duhet të kthejë përgjigje pa vonesë, por jo më vonë se 5 ditë kalendarike pas marrjes së kërkesës për tranzit, duke deklaruar nëse e pranon tranzitin dhe kohën për të cilën është planifikuar dhe përdorimin eventual të eskortës.

5. Afate kohore më të shkurtra mund të bihen dakord ndërmjet autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese, në raste të veçanta.

6. Në rast të një përgjigjeje negative, autoriteti kompetent i Palës së kërkuar duhet të japë arsyet për refuzimin e tranzitit.

7. Nëse Autoriteti Kompetent i Palës Kërkuese nuk ka specifikuar në aplikimin për tranzit datën e saktë, të dhënat e fluturimit ose të dhëna të tjera të rëndësishme, duhet të dorëzohet një njoftim tjetër mbi tranzitin e shtetasve të vendeve të treta apo personave pa shtetësi për të cilët autoriteti kompetent i palës së kërkuar ka dhënë pëlqim paraprak.

Neni 10

Eskortimi

1. Nëse ripranimi ose tranziti kryhet me eskortë, oficerët e eskortës duhet të kryejnë detyrat e tyre të paarmatosur, të jenë të veshur civilë dhe të kenë me vete pasaportë të vlefshme dhe dokumente që konfirmojnë kushtet e ripranimit apo të tranzitit.

2. Në rastet e tranzitit me rrugë ajrore, autoriteti kompetent i Palës së kërkuar mund të sigurojë, nëse është e nevojshme, mbikëqyrjen dhe imbarkimin e të kthyerit, në marrëveshje me oficerët e shoqërimit.

3. Pala e kërkuar duhet t'u ofrojë të njëjtën mbrojtje dhe asistencë oficerëve të policisë së Palës Kërkuese, në ushtrim të detyrave të tyre, në kuadër të këtij Protokolli, të cilat gëzohen nga oficerët e tyre të policisë që kryejnë detyra të ngjashme.

4. Mbikëqyrja dhe imbarkimi i personave të pashoqëruar në tranzit ajror duhet të sigurohet nga oficerët e policisë së Palës së Kërkuar, në bazë të kërkesës paraprake me shkrim në kreun C (vërejtje) të aplikimit për tranzit dhe konfirmimit nga autoriteti kompetent i Palës së kërkuar. Gjithashtu, autoriteti kompetent i Palës së kërkuar mund të marrë masa me iniciativë të vet.

Neni 11

Monitorimi

Në operacionet e kthimit që ndërmerren nga pala kërkuese, për transferimet ose tranzitet që kryhen në

zbatim të Marrëveshjes, duhet të lejohen organet kombëtare dhe ndërkombëtare monitoruese, të vëzhgojnë fazën e operacionit që kryhet në territorin e palës së kërkuar, duke përfshirë edhe dorëzimin e mundshëm të të kthyerve tek autoritetet e tyre, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

Neni 12
Shpenzimet

1. Shpenzimet për ripranim përfshijnë:

- shpenzimet e transportit deri në pikat e kalimit kufitar të përcaktuara në nenin 2 të këtij Protokolli Zbatimi;
- shpenzimet e eskortës të personave që eskortohen për arsye sigurie.

2. Shpenzimet e përmendura në paragrafët e mësipërm mbulohen në euro nga Pala kërkuese, siç është parashikuar në nenin 15 të Marrëveshjes.

3. Secila Palë Kontraktuese mbulon shpenzimet për lëshimin e dokumenteve të udhëtimit për shtetasit e saj, sipas neneve 2(2) dhe 4(2) të Marrëveshjes.

Neni 13
Hyrja në fuqi, përfundimi dhe amendimet

1. Protokolli i Zbatimit do të hyjë në fuqi tri ditë pasi Komiteti i Përbashkët i Ripranimit merr njoftimin për përfundimin e procedurave të brendshme ligjore të shteteve respektive, të nevojshme për këtë qëllim, në përputhje me nenin 19(2) të Marrëveshjes. Njoftimi duhet të dërgohet nga pala kontraktuese spanjolle menjëherë pasi palët kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përfundimin e procedurave të brendshme ligjore të nevojshme për këtë qëllim.

2. Ky Protokoll Zbatimi do të pushojë së zbatuari në të njëjtën kohë me Marrëveshjen.

3. Palët Kontraktuese mund të amendojnë këtë Protokoll Zbatimi me miratim të ndërsjellë. Amendimet do të hyjnë në fuqi në përputhje me procedurën e përcaktuar në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni.

4. Secila palë mund ta përfundojë këtë protokoll në çdo kohë, duke njoftuar me shkrim 6 muaj përpara palën tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike. Përfundimi i protokollit duhet t'i njoftohet Komitetit të Përbashkët të Ripranimeve.

Nënshkruar në Tiranë, më 5 prill 2018, në dy tekste origjinale në secilën prej gjuhëve të Palëve dhe në gjuhën angleze, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast të mosmarrëveshjeve për interpretimin e këtij Protokolli Zbatimi, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË
Rovena Voda
Zëvendësministre e Brendshme

PËR MBRETËRINË E SPANJËS
Vicente Canelles Montero
Ambasador i Mbretërisë së Spanjës në Republikën e Shqipërisë